



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova

Republic of Kosovo



**Komuna Skenderaj**

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor**

Në mbështetje të Statutit të Komunës së Skenderajt si dhe nenit 9, pika 1/4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së, për KKSBB-së dhe nenit 7.3 të ligjit Nr. 04/L-76 për Policinë, Kryetari i Komunës:

**THËRRET**

Mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), e cila do të mbahet më 31.10.2024 tetor gusht duke filluar nga ora 11:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve në ndërtesën e Komunës.

Për këtë mbledhje propozon këtë :

**REND DITE:**

- Miratimi i rendit të ditës
- Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- Diskutim rreth përgatitjeve për sezonin dimëror
- Diskutim rreth çështjeve të sigurisë
- Diskutim për masat në lidhje me vërshimet eventuale
- Diskutim rreth çështjes së qenve endacakë
- Diskutim rreth dhunës në familje
- Të ndryshme

Kryetari i Komunës  
  
Fadil Nura



## **Ekstrakt nga procesverballi i mbledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, i mbajtur me 04.09.2024**

**Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika të rendit të ditës:**

- Miratimi i rendit të ditës
- Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- Raport pune për periudhën 6 mujore të KKSBS-së (raporton Kryetari i Komunës, z.Fadil Nura)
- Diskutim rreth çështjeve të sigurisë
- Diskutim rreth fillimit të vitit të ri shkollor
- Të ndryshme

Kryetari Fadil Nura: Përshendetje të gjithëve! Konstatoj se kemi kourimin për vazhdim të mbledhjes. Besoj materialin e keni marrë me kohë. E hedh në votim rendin e ditës, kush është që të vazhdohet me këtë rend dite: Konstatoj se me votën e të gjithë anëtarëve miratohet rendi i ditës. Kalojmë te pika shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse nuk keni ndonjë vërejtje, kush jeni që të kalohet edhe kjo pikë: faleminderit! Vazhdojmë tutje me raportin e punës për periudhën 6 mujore të KKSBS-së. Sic e dini, në këtë periudhë kemi mbajtur mbledhjet e parapara me planin e punës së KKSBS-së, ku kemi diskutuar për shumë çështje të interesit publik të komunës së Skenderajt dhe qytetarëve. Gjatë kësaj periudhe ka qenë konstatim i përbashkët se Skenderaj vazhdon të jetë ndër komunat më të qeta sa i përket çështjes së sigurisë, gjithashtu në kuadër të përgjegjësisë të KKSBS-së kemi nxjerr rekomandime dhe kemi adresuar ato. Shpresoj të kemi këtë bashkëpunim me të gjithë akterët relevantë edhe në të ardhmen në mënyrë që të ofrojmë siguri për qytetarët dhe t'i adresojmë me kohë të gjitha çështjet që lidhen me punën e KKSBS-së. Nëse nuk keni dicka për të shtuar, e hedh në miratim edhe këtë pikë të rendit të ditës që lidhet me raportin e punës 6 mujore të KKSBS-së: të gjithë jeni për, faleminderit! Kalojmë te pika tjetër që ka të bëjë me sigurinë publike. Ia kaloj fjalën zëvendëskomandatit Agim Idrizi.

Agim Idrizi (Policia e Kosovës, Stacioni në Skenderaj): Faleminderit kryetar! Përshendetje të gjithëve! Sa i përket çështjes së sigurisë, vazhdojmë të kemi situatë të mirë, siguria është stabile. Kemi një bashkëpunim të mirë me Komunën dhe të gjitha institucionet tjera.

Valon Haliti, drejtor i Inspekcionit: Përshendetje të gjithëve! Ditëve të fundit janë paraqitur disa kërkesa nga qytetarët për vendosjen e pengesave rrugore. Kërkojmë prani të shtyar të policisë në bashkësi lokale, pasi ka vozitje të shpejtë nga veturat.

Agim Idrizi (Policia e Kosovës, Stacioni në Skenderaj): Jemi të gatshëm të ofrojmë bashkëpunim tonë dhe të ndërmarrim veprime konkrete në këtë drejtim. Ka qenë një periudhë sfiduese për shkak të aksidenteve rrugore. Kanë ndodhur 24 aksidente në trafik dhe janë lënduar 98 persona. Sa i përket kontrolleve në rrugë, policia e Kosovës do të shtojë angazhimin dhe aktivitetet për të parandaluar këtë dukuri të ngasjes së shpejtë në trafik. Sfidë kanë qenë edhe zjarrvëniet për cka kemi ndërmarrë veprime konkrete. Megjithatë do të jemi të gatshëm të kryejmë përgjegjësitë tona.

Milaim Dani: tashmë që ka filluar mësimi, në Runik nuk kam vërejtur ndonjë patrullë policore, do të ishte mirë që të ketë policë afër shkollës, për shkak të rrezikut.

Agim Idrizi (Policia e Kosovës, Stacioni në Skenderaj): Kemi planin operativ për këtë çështje. Policia e Kosovës do të jetë e pranishme afër shkollave, për të ofruar siguri edhe për nxënës.

Agron Kajtazi: Kam parë policë në terren, pra te shkollat. Në mëngjese mund të ketë rrezik, për shkak të numrit të madh të fëmijëve që shkojnë në shkollë.

Kryetari Nura: faleminderit për diskutimet, kush jeni që të votohet kjo pikë: faleminderit, kalojmë te pika e radhës, rreth fillimit të vitit të ri shkollor. Fjalën ia kaloj drejtorit të Arsimit, Kastriot Duraku.

Kastriot Duraku, drejtor i Arsimit: Falënderit dhe përshëndetje të gjithëve. Si drejtori me kohë kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Sivjet kemi disa ndryshme në sistemin arsimor. Gjimnazi është kthyer në objektin e mëparshëm, kurse në objektin e ri të gjimnazit zhvillohet mësimi për klasat nga 6-9. Në mënyrë që të kemi siguri edhe afër shkollave për shkak të trafikut, kërkojmë nga polica e Kosovës të shtojë kontrollet dhe praninë fizike të policëve. Sa i përket shkollave me numër të vogël të nxënësve, në bashkëpunim edhe me prindër dhe akterët tjerë, është vendosur të mbyllen disa shkolla, kurse ato do të kalojnë në shkollat amë.

Agron Kajtazi: kam disa shqetësime. Disa gjëra negative janë duke ndodhur, sic është shitja e cigareve, pijet energjike. Do të ishte mirë të kishte mbikëqyrje më të madhe nga inspektorati dhe policia e Kosovës. Janë shqetësuese këto dukuri. Kam vërejtur gjithashtu persona jokompetentë para shkollave, ka rrezik për imoralitet, pasi ka raste kur vajzat takohen me këta persona.

Milazim Mustafaj: shitja e cigareve është shqetësuese, këto raste janë vërejtur në dyqanat që operojnë në sheshin e qytetit.

Valon Haliti, drejtor i Inspektoriatit: vërtetë janë dukuri negative. Megjithatë kemi zhvilluar aktivitete parandaluese, kemi shqiptuar edhe masa për dyqanat ku kemi vërejtur këto dukuri. Do të hartojmë bashkërisht me policinë e Kosovës një plan, për të parandaluar këto dukuri.

Kastriot Duraku, drejtor i Arsimit: Sa i përket sigurisë në shkolla, janë duke u vendosur edhe kamerat e sigurisë, për cka këto kamera do të na ndihmojnë për luftimin e këtyre dukurive.

Valon Haliti, drejtor i Inspektoriatit: Megjithatë, pjesë të fajit kanë edhe prindërit. Ndërkaq drejtoria e shkollave është përgjegjëse për hapësirat brenda shkollës.

Kryetari Nura: Në këtë pikë, të gjithë së bashku mund të parandalojmë këto dukuri, duke u angazhuar secili nga përgjegjësia e tij që ka.

Rushit Jeta: Shitja e cigareve janë raste të izoluar, nuk është dukuri. Sfidë ka qenë ndarja e shkollave, megjithatë ka qenë një fillim i mirë i vitit të ri shkollor.


Kryetari Nura: nëse nuk keni dicka tjetër në këtë pikë, e hedh në votim. Konstatoj se me votat e të gjithë anëtarëve të KKS-së, kalon edhe kjo pikë. Kalojmë të pika standarde, të ndryshme:

Milazim Mustafaj: një pyetje, nëse një anëtar nuk merr pjesë asnjëherë në mbledhjet e KKS-së, a e hup mandatin?

Kryetari Nura: çështja e kompensimit të anëtarëve të KKSB-së, është një udhëzim administrativ që e ka ndaluar kompensimin, dhe problemi i mospjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhjet e KKSB-së, nuk ka të bëjë me çështjen e mospagesës. Nëse edhe në këtë pikë nuk keni dicka tjetër, e deklaroj të përfunduar mbledhjen. Faleminderit të gjithëve!

Procesmbajtësi:

Jeton Rushiti

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'JR', is written over a horizontal line.